

SHOQËRIA KONÇENSIONARE MARINA VLORË SH.P.K
LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE TIRANË – ELBASAN LUNDER FARKË, TIRANË
M12027029I

VENDIM
I
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me 09.09.2022 (dy mijë e njëzet e dy) ne oren 11:00 ne seline e “Shoqërisë Konçensionare Marina Vlorë” Sh.p.k (me tej referuar si “Shoqëria”), mbahet mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Jane te pranishem palet e meposhtme ortake te Shoqerise, konkretisht:

“MARINA DI VALONA” sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: “Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nacionale Tirane- Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG”, përfaqësuar nga administratori Eranda Muskaj, - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 50 % (pesëdhjete përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj;

“BRUNES.” sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS K37125203H me seli në adresën: “Tirane, Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km.7, ZK.2105, Ndertesa me Nr.Pasuries 187/23 dhe Nr.Pasurie 187/24” , përfaqësuar nga administratori Geront Çela, - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 50 % (pesëdhjetë përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj;

Z.Geront Çela, merr drejtimin e mbledhjes në cilësinë e Kryetarit dhe fton Eranda Muskaj te kryej detyrën e Sekretares se Mbledhjes se Asamblesë se Ortakeve deklarone vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklarone Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

Rendi i Ditës

- I. **Zmadhimi i Kapitalit të Shoqërisë “Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë” sh.p.k;**
- II. **Miratimi i injektimit të një vlere prej 370.000.000 lek (treqind e shtatëdhjetë milion lekë) në formën e kontributit monetar në kapitalin e Shoqërisë “MARINA DI VALONA” sh.p.k, e cila duke injektuar këtë kapital në Shoqërine “Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë” sh.p.k, rrit përqindjen e kuotës së saj në kapitalin e kësaj të fundit te barazvlefshme me 99,9999 % (nentëdhjete e nente pike nentemije e nenteqind e nentëdhjete e nente perqind);**
- III. **Miratimi i përqindjeve respektive të ndryshuara për secilin ortak pas miratimit të kapitalit shtesë të rritur të injektuar nga Shoqëria “MARINA DI VALONA” sh.p.k si më poshtë nga secili ortak ;**
- IV. **Të ndryshme ;**

Në lidhje me pikat në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali i shoqërisë është 1000 Lekë (një mijë lekë), përkatësisht shoqëria MARINA DI VALONA sh.p.k ka kontribuar kapital shumë më 500 Lekë (pesëqind lekë) e barazvlefshme me 50 % (pesëdhjetë përqind) dhe BRUNES. sh.p.k ka kontribuar në kapital 500 lekë (pesëqind lekë) e barazvlefshme me 50 % (pesëdhjetë përqind).



Në kuadrin e realizimit nga shoqëria "Shoqëria Konçensionare Marina Vlorë" sh.p.k e investimit të projektit "Porti i Jahteve Marina Vlorë" Kryetari i Asamblesë parashtron domosdoshmërinë e injektimit të likujditeve në kapitalin e Shoqërisë.

Përsa më sipër, Ortakët dëshirojnë të zmadhojnë kapitalin e shoqërisë dhe Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k ka shprehur interes të paguajë zmadhimin e kapitalit nëpërmjet kontributit në para me një vlerë prej **370.000.000 lek (treqind e shtatëdhjetë milion lekë)** ("Zmadhimi i Kapitalit"). Propozohet që Zmadhimi i Kapitalit të nënshkruhet nga Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k dhe të shlyhet në dy faza dhe jo më vonë se data 31 Dhjetor 2022 (dy mijë e njëzet e dy).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Të miratojnë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nëpërmjet kontributit në para në vlerën prej **370.000.000 lek (treqind e shtatëdhjetë milion lekë)** ("Zmadhimi i Kapitalit") ;
- B. Ky kontribut financiar i shtuar në Kapitalin e shoqërisë do të injektohet nga ortaku i Shoqërisë, shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k. ;
- C. Zmadhimi i Kapitalit do të shlyhet në dy faza dhe gjithësesi brenda dhe jo më vonë se data 31 Dhjetor 2022 (dy mijë e njëzet e dy). Më specifikisht:
 - I. Vlera prej **199.000.000 lek (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion lekë)**, do të derdhet në llogarinë bankare të Shoqërisë brenda dates **12.09.2022 (dy mijë e njëzet e dy)**;
 - II. Vlera prej **171.000.000 lek (njëqind e shtatëdhjetë e një milion lekë)** do të shlyhet plotësisht nga Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k deri në fund të muajit Dhjetor 2022 (dy mijë e njëzet e dy) ;
- D. Pasi Zmadhimi i Kapitalit të jetë shlyer tërësisht nga Ortaku shoqëria "MARINA DI VALONA" sh.p.k sipas pikës (C) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga **1000 LEK (një mijë Lekë)** do të bëhet **370.001.000 LEK (treqind e shtatëdhjetë milion e njëmijë lekë)** ;
- E. Duke u nisur nga kontributet :
 - Ortaku Marina di Valona sh.p.k do te zoteroje nje kuote në vlerën prej **370.000.500 LEK (Treqind e shtatëdhjetë milion e pesëqind lekë)** të barazvlefshme me **99.9999%** te kapitalit të Shoqërisë;
 - Ortaku Brunos sh.p.k do te zoteroje nje kuote në vlerën **500 LEK (pesëqind lekë)** të barazvlefshme me **0.0001 %** te kapitalit të Shoqërisë.
- F. Të autorizojë administratorin në detyrë që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi në Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

* * * * *


Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i



ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMEE ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"SHOQËRIA KONÇENSIONARE MARINA VLORË" SH.P.K**


**KRYETARI
BRUNES SH.P.K**



Geront Cela
Përfaqësues Ligjor i shoqërisë



**ORTAKI SHOQËRISË
MARINA DI VALONA SH.P.K**



Eranda Muska
Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë



